



Është gjithmonë e më në modë gjithçka që ka të bëjë me kozmetikën biologjike dhe “të gjelbërta”; tashmë klientët blejnë me zgjuarësi, duke bërë shumë kujdes me përbërësit e produteve dhe duke vlerësuar me kujdes raportin cilësi-çmim.

Por shpesh ama, çmimet e produteve kozmetike vërtet “të gjelbërta” janë shpesh shumë të larta, ndaj përse të mos e marrim në konsideratë edhe mundësinë për të kuruar bukurinë tonë me metoda “në kushtet e shtëpisë”? Neve ju sugjerojmë disa receta maskash fytyre plotësisht bio, të cilat mund të bëhen në shtëpi me fruta, perime dhe ndonjë përbërës lehtësisht të gjendshëm në dyqane produktesh bimore (erboristeri).

1. Maska me aromë vere



Është një maskë rifreskuese, qetësuese dhe që pastron lëkurën. Veçanërisht e përshtatshme për lëkura të ndjeshme, që skuqen lehtësisht.

Përbërësit

- 1 kokër domate e bërë
- 2-3 lugë argjile të bardhë të imët
- 2-3 gjethe borziloku
- 1/2 lugëza vaj ulliri

Përzieni domaten me borzilokun, shtoni pastaj vajin dhe 2 lugë argjile: në rast se përzierja del shumë e lëngshme, shtoni pak e nga pak argjilë tjetër për të përfutur një përbërje kremoze dhe homogjene.

Vendoseni në fytyrë për 15-20 minuta. Këshillohet një herë në javë.

2. Avokado për të hidratuar



Kjo maskë është shumë hidratuese, mbron lëkurën dhe ndihmon shumë lëkurën e stresuar nga agjentët atmosferikë apo ndotja. Këshillohet veçanërisht për lëkurat e thata dhe lëkurat që janë ekspozuar për një kohë të gjatë në diell.

Përbërësit

- 1 avokado e bërë
- 1 lugëz lëng limoni
- 1 lugëz vaj ulliri

Zhvishteni avokadon dhe hiqini bërthamën. Vendoseni tulin në një tas, hidhini lëngun e limonit dhe vajin e shtypeni fort me një pirun, derisa të keni përfutur një krem të butë dhe

homogjen.

Vendoseni në fytyrë për 30 minuta. Këshillohet 1-2 herë në javë.

3. Një lëng hidratues



Maska me banane dhe luleshtrydhe ka një efekt gjallërues dhe stimulues që, përveçse hidraton dhe zbut lëkurën, i jep asaj një ngjyrë të shëndetshme dhe shkëlqyese. Është e përshtatshme për të gjitha llojet e lëkurës.

Përbërësit

1 banane e bërë

3-4 luleshtrydhe të bëra

1 lug farash luledielli

Bëji farat e lulediellit pluhur, shtrydhni bananen dhe luleshtrydhet dhe përziejini bashkë të gjitha këto, derisa të keni përfutur një përbërje kremoze.

Vendoseni në fytyrë për 20 deri në 30 minuta, në varësi të tolerancës së lëkurës. Këshillohet 1-2 herë në javë.

4. Fara susami për të rinovuar qelizat



Maska me melasën e sheqerit dhe fara susami është natyrisht e pasur me acid glikolik dhe laktik dhe ka një efekt zbutës dhe stimulues, duke favorizuar rinovimin qelizor.

Përbërësit

1 lugë melase kallamsheqeri

1 lugë farash susami

1 lugëz kos

Bëjini pluhur farat e susamit në makinën grirëse dhe pastaj përziejini me melasën dhe kosin, derisa të përftoni një përbërje kremoze dhe homogjene.

Vendoseni përzierjen në fytyrë për 15 minuta. Këshillohet një herë në javë.

5. Krem bio kundra rrudhave



Maska me të verdhën e vezës, ose më mirë të themi, me majonezë, është hidratuese dhe opsioni kundër rrudhave për përsosmëri. Është e përshtatshme për lëkurat e mëdha në moshë, të thata dhe të stresuara.

Përbërësit

2 lugë kurkumi vajor ose vaj ulliri

1 lugëz lëng limoni

1 e verdhë veze

Përziejini në një tas lëngun e limonit dhe të verdhën e vezës, shtoni vajin me pika duke vazhduar përzierjen derisa vaji të jetë përthithur plotësisht.

Vendoseni në fytyrë për 20 minuta. Këshillohet 1-2 herë në javë.

6. Argjilë e gjelbër për të luftuar aknet



Maska e argjilës së gjelbër është purifikuese, ekuilibruese dhe veçanërisht e këshillueshme për lëkurat shumë të yndyrshme, me pika të zeza ose akne. Riekuilibron prodhimin e sebumit me tepicë dhe zhdok pamjen e yndyrshme dhe shkëlqyese të lëkurës.

Përbërësit

2 lugë argjile e gjelbër
1 pikë esencë livandoje
ujë i distiluar lulësh

Përziejini bashkë përbërësit, në mënyrë që të përftoni një përbërje të butë dhe homogjene. Vendoseni në fytyrë për 20 minuta. Këshillohet një herë në javë.